



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1519 Prot.

Tiranë, më datë 12.12.2023

VENDIM
Nr. 595, datë 12.12.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.12.2023:

VENDOSI:

1. Mosmiratimin e Raportit të vlerësimit mbi potencialin arkeologjik në kuadër të projektit “Rindërtimi i hotelit 4 kat+1kat nën tokë”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “A” Durrës, me vendndodhje Bashkia Durrës, hartuar nga subjekt i licencuar “JF Architectural Designer”, **me zhvillues Z. Nedi Ismaili** me argumentin:
 - Projekti bie në kundërshtim me VKM Nr. 786 datë 26.12.2018 “Për miratimin e Zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”, neni 3, gërma d).
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

